



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1748/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI217/19

Parashtrues

Astrit Shabiu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 77/2019,
të 10 qershorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Astrit Shabiu, nga fshati Smirë, Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 77/2019, të 10 qershorit 2019, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin AA. nr. 367/2018, të 19 dhjetorit 2018, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin A. nr. 729/16, të 4 majit 2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 28 gusht 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazi para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 29 nëntor 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 26 nëntor 2019.
7. Më 5 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 15 janar 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe po ashtu një kopje të kërkesës ia dërgoi edhe Gjykatës Supreme, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK) dhe Komunës së Vitisë. Të njëjtën ditë, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore dorëzimin e fletëkthesës, e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar ARJ-UZVP. nr. 77/2019, të 10 qershorit 2019, të Gjykatës Supreme.

9. Më 20 janar 2020, Gjykata pranoi fletëkthesën e dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 28 gusht 2020.
10. Më 29 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në bazë të shkresave të lëndës, të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës rezultoi se më 17 tetor 2012 ai kishte aplikuar për pozitën e Sekretarit Administrativ në Shkollën Fillore “Dëshmorët e 5 Prillit” në fshatin Smirë, Komuna e Vitisë.
12. Në konkursin e publikuar nga Komuna e Vitisë, ishte përcaktuar që kandidati të ketë diplomën e juristit të diplomuar dhe të ketë së paku tre vjet përvojë pune.
13. Si rezultat i përfundimit të procedurës së aplikimit dhe intervistimit dhe arritjes së pikëve maksimale, parashtruesi i kërkesës ishte pranuar në pozitën e lartcekur të Sekretarit Administrativ në këtë institucion mësimor.
14. Në një datë të paspecifikuar, dy kandidatët e tjerë, I.S. dhe XH. N., të cilët kishin konkurruar në të njëjtën pozitë, në cilësinë e palëve të pakënaqura kishin parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa në Komunën e Vitisë, ku kjo e fundit kërkesat e tyre i kishte refuzuar si të pabazuara.
15. Më 8 janar 2013, kundër Vendimit të Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, dy kandidatët në fjalë kishin parashtruar ankesë në KPMSHCK.
16. Në bazë të fakteve të rastit, të cilat reflektohen në vendimet e gjykatave të rregullta dhe të cilat nuk i janë bashkëngjitur dosjes nga ana e parashtruesit të kërkesës, rezultoi që fillimisht KPMSHCK, në një datë të paspecifikuar, kishte refuzuar ankesën e dy kandidatëve të tjerë. Pas kësaj, dy kandidatët e tjerë kishin parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore, në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), me kërkesën për anulimin e Vendimit të KPMSHCK. Në një datë të paspecifikuar, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit A. nr. 264/13 kishte aprovuar kërkesën e dy kandidatëve të tjerë dhe lëndën e kishte kthyer në rivendosje në KPMSHCK.
17. Më 1 prill 2016, KPMSHCK përmes Vendimit nr. A02/77/2016 (nr. Protokollit 1283/2016), aprovoi ankesën e dy kandidatëve I.S. dhe XH. N., dhe vendosi për anulimin e konkursit të shpallur më 17 tetor 2012. KPMSHCK konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte plotësuar kriterin e përvojës së punës pas diplomimit të kërkuar në konkurs.
18. Më 26 prill 2016, si rezultat i Vendimit të KPMSHCK parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e tij e punës.

19. Më 16 prill 2016, Komuna e Vitisë, parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore përmes të cilit ishte kërkuar që të anulohet Vendimi i KPMSHCK, A02/77/2016, i 1 prillit 2016.
20. Më 4 maj 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit, A. nr. 729/16, kërkesëpadinë e Komunës së Vitisë e refuzoi si të pabazuar.
21. Gjykata Themelore kishte zhvilluar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë kishin marrë pjesë Komuna e Vitisë, në cilësinë e paditëses, KPMSHCK në cilësinë e të paditurës dhe parashtruesi i kërkesës në cilësinë e palës së interesuar. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e palës së interesuar kishte pretenduar se KPMSHCK nuk kishte vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe për pasojë në mënyrë të gabuar kishte zbatuar nenin 28 të Rregullores së Punës 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil.
22. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj, fillimisht, iu referua dispozitave të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil, përkatësisht nenit 19, i cili përcakton që shqyrtimi i aplikacioneve është faza e parë e përzgjedhjes në procesin e rekrutimit. Në vijim, Gjykata Themelore po ashtu iu referua edhe nenit 28 të kësaj Rregulloreje, i cili përcakton kriteret për përfshirjen në listën e shkurtër, dhe i cili specifikon që anëtarët e KPSHC [Komision Përzgjedhës i Shërbimit Civil] vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimit dhe kualifikimit profesional, përvoja e punës, shkathtësitë dhe aftësitë, si dhe elementet e tjera për punësim. Gjykata Themelore iu referua edhe nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Shërbimin Civil) i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë publike dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”*.
23. Në vijim të kësaj, Gjykata Themelore, duke iu referuar provave të administruara, vërtetoi se *“parashtruesi i kërkesës ka aplikuar në konkursin e shpallur më 17 tetor 2012, nga Komuna e Vitisë për vendin e lirë të punës Sekretar Administrativ në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët “5 Prill” në fshatin Smirë, ku i njëjti është përzgjedhur si kandidat më i mirë me shkrim dhe me gojë me 70.4 % të pikëve. Më tutje, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me 8 tetor 2013 i kishte lëshuar njohjen e gradës jurist i diplomuar për studime katërvjeçare, e fituar në Universitetin e Tetovës [...]”*. Andaj i njëjti në kohën e aplikimit nuk ka përmbushur përvojën e punës pas diplomimit, ashtu siç ka qenë e përcaktuar në konkurs, respektivisht e gjitha përvoja e tij ka qenë para diplomimit, e kjo tashmë e vërtetuar edhe nga Trusti Pensional i Kosovës.” Rrjedhimisht, Gjykata Themelore konstatoi se gjatë procedurës së rekrutimit nga ana e Komunës së Vitisë nuk është vërtetuar gjendja faktike dhe juridike nga ajo e vërtetuar nga KPMSHCK.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës (në cilësinë e palës së interesuar) parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

25. Më 19 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit, AA. nr. 367/2018, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
26. Gjykata e Apelit, përmes këtij Aktgjykimi, e vërtetoi si të drejtë dhe të bazuar në ligj konstatimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit theksoi se *“përkundër se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas bazës ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar [i Gjykatës Themelore] nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës [KPM SHCK] në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së”*.
27. Në vijim, Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me interpretim të gabuar të legjislacionit për Shërbimin Civil përkitazi me përvojën e punës *“Këto pretendime janë të paqëndrueshme meqë gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses [komunës së Vitisë ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses dhe tani pretendimet [e parashtruesit të kërkesës] janë të pabazuara.”* Sipas Gjykatës së Apelit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga KPM SHCK dhe Gjykata Themelore dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës.
28. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshme të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kontestoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se i njëjti është i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht pretendoi interpretim të gabuar të nenit 28 të Rregullores së Punës 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil.
29. Më 10 qershor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr. 77/2019, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
30. Gjykata Supreme vërtetoi në tërësi qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, duke konstatuar se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje të së drejtës materiale. Në këtë vazhde, Gjykata Supreme vërtetoi se në mënyrë të drejtë ishin zbatuar dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenet 19 dhe 28, si dhe nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil, i cili përcakton që pranimi në Shërbimin Civil bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, na bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.
31. Gjykata Supreme konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e palës së interesuar për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara për shkak se nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendjeje tjetër faktike

nga ajo se çfarë konstatoi gjykata e shkallës së dytë. Sipas Gjykatës Supreme, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit është i qartë, i kuptueshëm dhe se përmban arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuar me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazi para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
33. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31, parashtruesi i kërkesës pretendon se interpretimi i dhënë nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar është *"arbitrar ne faktin se askund në konkurs nuk ka shkruar se përvoja duhet të jetë para apo pas diplomimi, andaj interpretimi i tyre është i pa bazuar në ligj, mirëpo vetëm copy paste është bërë nga aktgjykimet e mëparshme [...]"* Parashtruesi në vijim specifikon se si rezultat i interpretimit arbitrar nga ana e Gjykatës Supreme ai ka humbur punën. Sipas parashtruesit të kërkesës *"[...] kompetence e komunës -punëdhënësit është për të parashtruar kritere për punësim, prandaj interpretimi i diqkaje që ska qenë ne konkurs është arbitraritet dhe është përzierje ne institucionin komunal te punësimit"*.
34. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"institucionet e lartpërmendura, përmes vendimeve të tyre bëjnë cenim kushtetues të nenit 23 - Dinjiteti i Njeriut, duke shkelur dinjitetin tim, pasi që unë kam qenë jurist i diplomuar, kam patur përvojën e punës, mbi tre vite, ashtu si ka qene e precizuar ne konkurs të dëshmuar edhe me trust, përse të më ndërprehet marrëdhënia e punës?"*.
35. Tutje, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, duke theksuar se: *"[gjykatat e rregullta] përmes interpretimeve te tyre kane ve ne dispozicion kritere diskriminuese, përkatësisht kane krijuar praktike te pa bazuar ne ligje dhe e cila nuk është fare interes publik. Me konkretisht interpretimi i tyre është arbitrar, duke mos u thirrur saktë në normën ligjore. Duke mos zbatuar dispozitat me te favorshme për palën - e dëmtuar, mua, përkatësisht nuk gjykojnë dy kohe: legjislacionin e vitit 2012 dhe te atij 2016. Përkatësisht Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, nuk thirren sakte ne dispozitat që rregullojnë shërbimin civil ne Republikën e Kosovës dhe gjithë ashtu nuk zbatojnë drejt te drejtën materiale, gjithashtu është për tu habitur se nuk njohin si fakt edhe aktet administrative deklarative"*.
36. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se: *"[...] më mohojnë të drejtën time kushtetuese për punë, si dhe të drejtën time për zgjedhjen e një profesioni. Me vendimet e tyre, kan cenuar dispozitat kushtetuese, duke më pamundësuar mua që të ushtroj profesionin tim si jurist i diplomuar, duke bërë interpretime diskriminuese si dhe duke krijuar monopol punësimi, kur dihet se KPMSHCK, me interpretimin se përvoja e punës njihet"*

vetëm pas diplomimi, shkel te drejtën për ushtrimin e një profesioni si dhe te drejtën për punë. Është absurde si të mos njihet një person si jurist i diplomuar nëse nuk e ka përvojën pas diplomimi? Si te ushtrohet profesioni i juristit kur kemi cenim të kësaj të drejtë pasi që KPMSHCK, Gjykata Themelore, ajo e Apelit, departamentet Administrative si dhe Gjykata Supreme e autorizojnë veten se çfarë duhet të jetë përvoja e punës para apo pas diplomimi dhe kështu mendoj se kemi të bëjmë me shkelje te nenit 49 te Kushtetutës”.

37. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Institucionet e lartpërmendura, përmes vendimeve të tyre të pa bazuara në legjisllacionin e shërbimit civil, kanë krijuar praktike të keqe, duke kufizuar liritë dhe te drejtat e garantuara kushtetuese, dhe me këtë rast mendoj se ka cenim te nenit 55-Kufizimi i te Drejtave dhe Lirive Themelore”.*
38. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar edhe Opinionin e Zyrës së Avokatit të Popullit, nr. 207/2018, të 31 janarit 2018. Këtë Opinion, Zyra e Avokatit të Popullit e kishte dorëzuar ne cilësinë e Amicus Curiae, *“në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit të 'përvojës së punës' në kontekstin e konkurseve për punësim ne institucione publike, ofruar: Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, dhe Ministrisë së Administratës Publike.”* Në pjesën hyrëse të këtij Opinioni theksohet se *“Ky opinion juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim ofrimin e ndihmës ligjore për krijimin e mundësisë së një interpretimi të drejtë të konceptit “përvojë e punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike [...]”.*
39. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se Opinioni i Avokatit të Popullit *“vërteton bindshëm dhe në mënyrë të argumentuar pretendimet e mia.”* Sipas parashtruesit, *“Interpretimi sipas institucioneve të lartpërmendura se: 'përvoja e punës njihet vetëm pas diplomimit', nuk është interes publik, si dhe krijon kritere përjashtuese ne konkurse publike, përkatësisht cenon interesin publik dhe kufizon pa te drejtë liritë dhe te drejtat themelore te njeriut, si dhe iu mohon te sapodiplomuarve te konkurrojnë për pozita te ndryshme”.*
40. Në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se *“sipas vendimeve të Gjykatave të lartpërmendura mes tjerash thuhet se kandidati Astrit Shabiu, nuk e ka patur te nostrifikuar diplomën, pasi që studimet janë kryer ne Universitetin shtetëror te Tetovës. Dihet se ne konkursin ne fjale nuk ka qene kriter nostrifikimi, mirëpo mbështetur në praktikën e mëparshme, dihet se të gjithë të diplomuarit me sistem të vjetër ish jugosllav, nuk kanë nevojë për nostrifikim edhe pse tanimë unë e kam vendimin mbi nostrifikimin në fjalë dhe i cili mendoj se është akt administrativ deklarativ, dhe si te tille nuk e njohin Instancat e lartpërmendura”.*
41. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP nr. 77/2019, i 10 qershorit 2019, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit AA. nr. 367/2018, i 19 dhjetorit 2018, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore A. nr. 729/16, i 4 majit 2018 *“të vlerësohen si jo kushtetuese, të shfuqizohen dhe të anulohen”.*

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

(...)

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

- 1. E drejta e punës garantohet.*
- 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.*

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. 3. Kufizimet e të drejtave dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe liritë të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Neni 11 Pranimi në Shërbimin Civil

1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

[...]

Rregullore nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimin në Shërbimin Civil

Neni 19 Procedurat e shqyrtimit

Shqyrtimi i aplikacioneve është faza e parë e përzgjedhjes në procesin e rekrutimit. Qëllimi i shqyrtimit është përgatitja e një liste të shkurtër të kandidatëve të kualifikuar për procedim të mëtejshëm pas vlerësimit të profilit, meritave dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara në pozitat përkatëse.

Neni 28 Kriteret për përfshirjen në listën e shkurtër

1. Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijim:
 - 1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional;
 - 1.2. përvoja e punës;
 - 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë;
 - 1.4. elementet e tjera të meritës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Gjykata, së pari, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

44. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

45. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 77/2019, të 10 qershorit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me

Ligj. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

46. Gjykata sqaron se, përveç këtyre kritereve, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës Gjykata duhet po ashtu t'i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) i Rregullores përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

47. Në dritën e kësaj, Gjykata vë theksin në pretendimet e parashtruesit të kërkesës se përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 77/2019, të 10 qershorit 2019, atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese në vijim: e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; e drejta në punë dhe ushtrimin e profesionit; e drejta në dinjitet; barazia para ligjit; kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore.
48. Në dritën e këtyre pretendimeve, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata në vijim do të aplikojë standardet e praktikës së saj gjyqësore, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Në këtë drejtim, duke qenë se thelbi i pretendimeve dhe argumenteve të parashtruesit të kërkesës lidhet me standardet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, siç e garanton neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do shqyrtojë këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.

(i) Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

50. Për sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me nenin 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës është se gjykatat e rregullta, sikundër edhe KPMSHCK, kanë bërë interpretim të gabuar dhe arbitrar të dispozitave përkatëse ligjore për pranimin në shërbimin civil, kur kanë vendosur për mosnjohjen e përvojës së tij të punës para diplomimit. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk ka precizuar se cili ka qenë profesioni apo përvoja e tij e ushtruar para diplomimit.
51. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht thekson se, si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe, si të tilla, parimisht, nuk janë çështje të Gjykatës Kushtetuese (shih rastet nr. KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

52. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me mënyrën se si gjykatat e rregullta bëjnë konstatimin e fakteve ose interpretimin e ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato (gjykatat e rregullta) mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë arsyet faktike dhe ligjore që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim, në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata Kushtetuese do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Pra, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese ne rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
53. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e cituar më lart, KI75/17, paragrafi 59).
54. Prandaj, duke u bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet e tij për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
55. Në këtë vazhdë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike konteston aktgjykimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, përmes së cilave ishte vërtetuar edhe konstatimi i KPMSHCK se parashtruesi i kërkesës nuk kishte përvojën e nevojshme të punës për pozitën për të cilën kishte aplikuar.
56. Duke iu referuar procedurave të zhvilluara në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se pas Vendimit të KPMSHCK, përmes të cilit ishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk e plotësonte kriterin e përvojës së punës dhe, për pasojë, e kishte anuluar konkursin e publikuar nga Komuna e Vitisë, kjo e fundit kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore me kërkesë për anulimin e Vendimit të lartcekur të KPMSHCK. Në procedurat para Gjykatës Themelore, në cilësinë e palës së interesuar, kishte marrë pjesë edhe parashtruesi i kërkesës, të cilit i ishte dhënë mundësia e paraqitjes së pretendimeve të tij.
57. Gjykata Themelore, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, përmes Aktgjykimit të saj kishte refuzuar kërkesën e Komunës së Vitisë duke vërtetuar konstatimet e KPMSHCK se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte plotësuar kriterin e përvojës së punës. Duke u mbështetur edhe në provat e administruara dhe në mënyrë specifike në të dhënat e Trustit Pensional të Kosovës, kjo Gjykatë kishte arritur në përfundim se parashtruesi i kërkesës nuk kishte plotësuar kriterin e përvojës së punës. Gjykata Themelore, në këtë rast, iu referua dispozitave përkatëse që përcaktojnë kriteret dhe procedurat për pranimin në Shërbimin Civil, përkatësisht neneve 19 dhe 28 të Rregullores nr. 02 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil dhe nenin 11 të Ligjit për Shërbimin Civil.

58. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj në tërësi i kishte vërtetuar konstatimet e Gjykatës Themelore. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme. Në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar interpretim dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht të nenit 28 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nga ana e Gjykatës së Apelit.
59. Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës (në cilësinë e palës së interesuar), për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, duke konstatuar se ajo ishte e pabazuar. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, në tërësi kishte vërtetuar vlerësimin dhe konstatimet e dhëna përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke konkluduar se interpretimi i kësaj të fundit ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme vërtetoi se në mënyrë të drejtë ishin zbatuar dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenet 19 dhe 28, si dhe neni 11 i Ligjit për Shërbimin Civil, i cili përcakton që pranimi në Shërbimin Civil bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, na bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.
60. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, kanë mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme, për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.
61. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se konstatimet e gjykatave të rregullta, në veçanti të Gjykatës Supreme, nuk janë të bazuara në ligj bien në kategorinë e pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, sepse ngërthejnë çështje që ndërlidhen me vërtetimin e gjendjes faktike dhe interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “*ligjshmërisë*” dhe jo “*kushtetutshmërisë*”.
62. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për zbatim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme përmes të cilit ishte vërtetuar vlerësimi dhe konstatimi i KPMSHCK, i Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe, rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 23, 24, 49 dhe 55 të Kushtetutës

63. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave të Njeriut] të Kushtetutës.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 23 të Kushtetutës

64. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 23 të Kushtetutës [Dinjiteti i Njeriut], duke theksuar se përmes vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, përmes të cilave është vendosur lidhur me mospërmeshjen e kriterit të përvojës së tij të punës, atij i është shkelur dinjiteti. Gjykata vë theksin në faktin se mbrojtja e dinjiteti të njeriut nuk është vetëm një e drejtë individuale, por paraqet bazament të të gjitha të drejtave themelore që ofron Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe nuk ka argumentuar se si Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur dinjitetin e tij.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

65. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës [Barazia para Ligjit], për arsye se, sipas tij, *“gjykatat e rregullta përmes interpretimeve të tyre kanë vë në dispozicion kritere diskriminuese, përkatësisht kanë krijuar praktikë të pa bazuar në ligje dhe e cila nuk është fare interes publik”*.
66. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të barazisë para ligjit, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, *ose status*, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, shih, po ashtu, rastet e GJEDNJ-së *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, kërkesat nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72, 7 dhjetor 1976, paragrafi 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 42184/05, Aktgjykim i 16 mars 2010, paragrafi 61). Sipas këtyre praktikave gjyqësore, jo çdo dallim në trajtim do të jetë diskriminues, por vetëm nëse i mungon justifikimi objektiv dhe i arsyeshëm, gjegjësisht nëse nuk ndjek një qëllim legjitim apo nëse i mungon marrëdhënia e arsyeshme ndërmjet mjeteve që përdoren dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Guberina kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 22 marsit 2016, dhe referencat e tjera të përmendura aty).
67. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij se si është trajtuar ndryshe nga persona të tjerë në situatë të ngjashme dhe, rrjedhimisht, nuk ka mbështetur pretendimin e tij për diskriminim në procedurë para KPMSHCK dhe gjykatave të rregullta.

68. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

69. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe, sipas tij interpretimeve diskriminuese nga kjo e fundit, atij i është mohuar e drejta e tij në punë dhe ushtrimin e profesionit.
70. Në sfondin e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje praktikën e saj ku është sqaruar se Kushtetuta përkufizon një standard që ngërthen garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta janë të rregulluara në mënyrë më specifike me ligjet e aplikueshme (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI46/15, me parashtruese *Zejna Qosaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; KI70/17, parashtrues *Rahim Ramadani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2018, paragrafi 48; dhe KI115/19, parashtruese *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2019, paragrafi 65).
71. Gjykata thekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, argumenton se atij i është cenuar e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin KI115/19, parashtruese *Sadete Jusufi* të cituar më lart, paragrafi 66).
72. Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konstatimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimi i tij për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 55 të Kushtetutës

73. Në kërkesë, parashtruesi po ashtu ka pretenduar shkelje të nenit 55 të Kushtetutës, duke pretenduar se interpretimi i gjykatave të rregullta, përmes të cilave mohohet njohja e përvojës së punës para diplomimit, cenon interesin publik dhe kufizon të drejtat dhe liritë e njeriut. Në lidhje me këtë pretendim specifik, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe Opinionit nr.207/2018, të 31 janarit 2018, të Zyrës së Avokatit të Popullit në cilësinë e *Amicus Curiae* “*në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit 'përvojës së punës' në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike, ofruar: Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, dhe Ministrisë së Administratës Publike*”.

74. Në këtë sfond, Gjykata thekson se neni 55 i Kushtetutës përcakton kriteret dhe rrethanat kur të drejtat dhe liritë e njeriut mund të kufizohen në pajtim me Kushtetutën. Neni 55 i Kushtetutës, përcakton nëse: (i) kufizimi është parapare me ligj; (ii) ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me kufizimin; dhe (iii) ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.
75. Gjykata rikujton se çështja e interpretimit të përvojës së punës është ngritur edhe në kontekst të pretendimit për shkelje të nenit 31, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit si dhe pretendimit për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se ajo tashmë ka konstatuar se këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
76. Prandaj, në dritën e pretendimeve dhe argumenteve të paraqitura në kërkesë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se si dhe në çfarë mënyre kjo dispozitë e Kushtetutës është shkelur në rastin e tij.
77. Për sa më sipër, dhe në ndërlidhje të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 23, 24, 49 dhe 55 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtruese *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019).
78. Rrjedhimisht, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në lidhje me nenet 23, 24, 49 dhe 55 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, Gjykata konstaton se këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

79. Për arsyet e paraqitura më lartë, Gjykata përfundon se bazuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me pretendimet e tij për shkelje të neneve 23, 24, 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht kërkesa e tij duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 29 mars 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi